



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:270731
Datë: 17.04.2024
Numri i dokumentit: 05584738

C-IV-14-6058

Paditësi/Ankuesi

A U nga Prizreni, përfaqësuar nga avokat S R, nga Prizreni

Kundër

E Paditura/Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (NSH “Progres” – “Lavërtari – Blegtori” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (“DHPGJS”), kolegji i përbërë nga Gazmend Sylaj, gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Hajrie Shala, gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 prill 2024, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- Dhoma e Posaçme jep pëlqimin mbi tërheqjen e ankesës.**
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 28 gusht 2014, pranë DHPGJS, ankuesi, parashtrij një ankesë me të cilin e kundërshtoj NJOFTIMIN e Autoritetit të Likuidimit (AL) të AKP, nr. 27106 datë 16 korrik 2014, me të cilin njoftim është informuar mbi inicimin e procedurës së likuidimit NSH “Progres” – “Lavërtari – Blegtori”.

Ankuesi me ankesë, i referohej dispozitave ligjore të Ligjit të AKP dhe Shtojcës së po këtij ligji (nenin 2, 3, 11, 14, 7, 9 dhe 49).

Ankuesi me ankesë ka përshkruar kompetencat e Bordit të AKP, referuar në atë se anëtarët ndërkombëtar të Bordit mund të ndalojnë të gjitha Vendimet e Bordit, nëse konsiderojnë se është

janë kundërshtim me Konventën Evropiane mbi Liritë dhe të Drejtat e Njeriut gjer në vendimin përfundimtar të DHPGJS.

Nga kjo arsye konsideron se edhe Vendimet e AL nëse konsiderohen se janë në kundërshtim me KELDNJ mund të apelohej pranë DHPGJS dhe veprimet e AL të ndalohen gjer në vendimin përfundimtar të gjykatës.

Ankuesi pohon se pranë DHPGJS, ka parashtruar një padi mbi anulimin e Kontratës mbi dhuratën si dhe ka kërkuar dorëzimin e paluajtshmërisë. Kjo padi, pranë DHPGJS, evidentohet si lënda C-III-12-0148.

Nga kjo arsye, ankuesi konsideron se fakti se pranë DHPGJS zhvillohet një procedure gjyqësore e karakterit pronësor, atëherë procedura e likuidimit duhet të ndërpritet për të vetmen arsye se ka të bëjë me një kërkesë pronësore e jo edhe monetare.

Ankuesi pretendon në të drejtën e tij mbi anulimin e Kontratës mbi dhuratën, bazuar në dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve si dhe të drejtën e pronësisë së ngastrave kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 00.11.46 ha.

Nga gjitha arsyet u kërkuar që gjykata ta shfuqizoj Vendimin- njoftimin mbi inicimin e procedurës së likuidimit të NSH.

Kërkesës- ankesës i janë bashkangjitur:

- Kopja e padisë, parashtruar pranë DHPGJS (pa vulë pranimit), e parashtruar nga paditësit F K dhe të tjerët nga AKP, NSH “Progres” – “Lavërtari – Blegtori” dhe Komunës së Prizrenit,
- Disa kopje të shkresave të lëndës, C-III-12-0148, dhe
- Kopja e Njoftimit mbi fillimin e likuidimit të NSH, nr. 27106 datë 16 korrik 2014, lëshuar nga AL.

Duke vepruar sipas urdhrorit të gjykatës, përfaqësuesi i ankuesit parashtron kopjen e autorizimit, të noterizuar, për ankuesin A U E U, S B, F K, M U dhe H U

Gjykata ftoj palët për seancën e parë dëgjimore, të caktuar për datën 11 prill 2024, me fillim në ora 13.30.

Prezent, në seancë, përfaqësuesi i ankuesit dhe përfaqësuesi i AL.

Përfaqësuesi i ankuesit informoj kolegjin se pranë DHPGJS tani më zhvillohet një procedurë tjetër gjyqësore e cila evidentohet sipas lëndës C-III-23-0151, lëndë kjo në të cilën ankuesi ka parashtruar kërkesë kompensimi monetar të ngastrës kadastrale. Nga kjo arsye përfaqësuesi i ankuesit konsideroj se zhvillimi i procedurës sipas kësaj lënde, C-IV-14-6058, është i pakuptimtë andaj edhe kërkoj që ankesa të konsiderohet e tërhequr.

Arsyetimi Ligjor

Neni 34.1 i Ligjit për DHPGJS (Ligji nr. 06/L-086) parasheh që, paditësi/t/ankuesi/t mund ta tërheqin padinë/ankesën e tij/tyre në çdo kohë me pajtimin e Dhomës së Posaçme. Me dhënien e pëlqimit të saj Dhoma e Posaçme merr parasysh interesin e të gjitha palëve tjera.

Kolegji mori parasysh interesin e të gjitha palëve në këtë procedurë dhe vendosi të japë pëlqimin për tërheqjen e ankesës.

Andaj u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

Shpenzimet

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendim mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Hajrie Shala, Gjyqtare
